



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.156

27 nëntor

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i GJK
nr.40, datë 16.11.2007

Me objekt shfuqizimin e fjalës “vendbanim” në nenin 63, pika 3 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003, ndryshuar me ligjin nr.9297, datë 21.10.2004 dhe ligjet nr.9341, datë 10.1.2005, nr.9371, datë 14.4.2005, si dhe ligjin nr.9676, datë 13.1.2007 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” si e papajtueshme me Kushtetutën..... 4529

Vendim i GJK
nr.41, datë 16.11.2007

Me objekt shfuqizimin e Republikës së Shqipërisë i ligjit nr.9650, datë 27.11.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8607, datë 27.4.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, i ndryshuar” si i papajtueshëm me Kushtetutën 4534

Vendim i GJL
nr.10, datë 12.9.2007

Me objekt detyrimin e palës së paditur, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të më shpërblejë dëmin për shkak të zgjidhjes së menjëhershme dhe pa shkaqe të kontratës së punës nga punëdhënësi në masën 20 e ½ të pagave mujore, si dhe rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës..... 4540

VENDIM
Nr.40, datë 16.11.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergji Sauli	anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	anëtar i “ “
Kristofor Peçi	anëtar i “ “
Kujtim Puto	anëtar i “ “
Petrit Ploçi	anëtar i “ “
Sokol Sadushi	anëtar i “ “
Sokol Berberi	anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datë 19.6.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.40 Akti, që i përket:

KËRKUES: Avokati i Popullit, përfaqësuar nga Ervin Karamuço, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. Kuvendi i Shqipërisë, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj, me autorizim.

2. Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Edmond Dunga, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i fjalës “vendbanim” në nenin 63, pika 3 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003, ndryshuar me ligjin nr.9297, datë 21.10.2004 dhe ligjet nr.9341, datë 10.1.2005, nr.9371, datë 14.4.2005, si dhe ligjin nr.9676, datë 13.1.2007 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

Kërkuesi ka pretenduar papajtueshmërinë e fjalës “vendbanim” me Kushtetutën, të parashikuar nga neni 63/3 i Kodit Zgjedhor, pasi kjo fjalë kushtëzon ushtrimin e të drejtës së votës me faktin që të burgosurit ose të paraburgosurit të jenë banorë në zonën ku vuajnë dënimin. Në këtë mënyrë, sipas kërkuesit, të burgosurit që kanë vendbanim të ndryshëm nga ai i vuajtjes së dënimit vendosen në pamundësi për të ushtruar të drejtën e votës, duke cenuar kështu një të drejtë të parashikuar nga neni 45/3 i Kushtetutës.

Sa i përket legjitimitetit të tij, kërkuesi e argumenton të drejtën për t’u drejtuar me këtë kërkesë Gjykatës Kushtetuese me faktin se neni 60 i Kushtetutës dhe ligji për Avokatin e Popullit janë në përputhje me nenin 49/2 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Sipas kërkuesit, nuk ka asnjë pengesë kushtetuese ose ligjore për legjitimitetin e Avokatit të Popullit, në kuptim të nenit 134/1, shkronja “dh”.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar i Kuvendit të Shqipërisë, është shprehur se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara, duke parashtruar se:

- Kërkesa është paraqitur tej afateve ligjore të parashikuara nga neni 50 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”;

- Të burgosurit nuk privohen nga e drejta e tyre për të votuar, pasi ata janë të regjistruar në listat e zgjedhësve të vendbanimeve të tyre. Çështja e realizimit konkret të kësaj të drejte nga të burgosurit nuk të çon detyrimisht në përfundimin se dispozita e Kodit Zgjedhor është antikushtetuese;

- Të burgosurit ndodhen në të njëjtën pozitë, si edhe personat me shtetësi shqiptare dhe vendbanim jashtë Shqipërisë, studentët, ushtarakët etj., të cilët vetëm për zgjedhjet parlamentare kanë të drejtë të votojnë në vendqëndrimet e tyre, kurse për zgjedhjet vendore duhet të votojnë pranë vendbanimit të tyre. Kjo dispozitë është formuluar në këtë mënyrë për shkak të lidhjes së drejtpërdrejtë që ka zgjedhësi me drejtuesit e njësisë vendore.

Përfaqësuesi i Këshillit të Ministrave kundërshtoi pretendimet e kërkuesit me këto argumente:

- Kërkuesi nuk legjitimohet ta vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, pasi nuk ndodhemi para rastit kur janë cenuar të drejtat, liritë apo interesat e ligjshme të individëve nga veprime apo

mosveprime të organeve të administratës publike. Sipas subjektit të interesuar, ligji nuk është akt i administratës publike dhe për këtë arsye kërkuesi nuk mund të kërkojë papajtueshmërinë e tij me Kushtetutën para kësaj Gjykate për mungesë legjitimitimi;

- Kërkuesi nuk duhet ta mbështesë pretendimin e tij mbi nenin 3 të protokollit shtesë nr.1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, pasi kjo dispozitë e shtrin efektin vetëm për zgjedhjet e përgjithshme dhe jo për ato vendore;

- Të burgosurve nuk u është mohuar e drejta e votës, ajo thjesht është lidhur me konceptin e vendbanimit, pasi vetë karakteri i zgjedhjeve vendore e kushtëzon këtë lidhje midis zgjedhësve dhe të zgjedhurve. Mungesa e parashikimeve ligjore përkatëse për ta bërë efektiv ushtrimin e të drejtës së votës për të burgosurit që nuk kanë vendbanimin në vendin e vuajtjes së dënimit, nuk do të thotë se dispozita e nenit 63/3 e Kodit Zgjedhor është antikushtetuese.

GYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Xhezair Zaganjorin, përfaqësuesin e kërkuetit, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me ligjin nr.9341, datë 1.10.2005 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, është ndryshuar, midis të tjerave, edhe dispozita e nenit 63 e këtij Kodi, e cila thotë: “Në burgjet dhe në vendet e paraburgimit, për zgjedhjet dhe referendumet vendore, 40 ditë para datës së votimit, drejtuesi i institucionit përgatit listën e zgjedhësve me vendbanim në njësinë zgjedhore, ku ndodhet institucioni dhe ia dorëzon atë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse.”

Ndryshimet që iu bënë kësaj dispozite kishin për qëllim realizimin e të drejtës së votës së personave të ndodhur në institucione të posaçme, pra të burgosurve dhe të paraburgosurve. Duke iu referuar nenit 50 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se kërkesat para Gjykatës Kushtetuese për papajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose marrëveshjet ndërkombëtare paraqiten brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e tyre, rezulton se kërkesa e paraqitur nga Avokati i Popullit është brenda afatit ligjor të parashikuar për këtë qëllim.

Gjykata Kushtetuese vlerëson si të nevojshme që së pari të shprehet mbi legjitimitimin e kërkuetit. Lidhur me këtë Gjykata çmon se Avokati i Popullit legjitimohet në paraqitjen e kërkesës së tij para kësaj Gjykate. Siç është theksuar edhe në praktikën e mëparshme të kësaj Gjykate, Avokati i Popullit, si një nga subjektet që mund ta vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese në bazë të nenit 134/2 të Kushtetutës, duhet ta justifikojë interesin e tij në çështjen konkrete. Interesi i tij duhet të lidhet me funksionin kushtetues që ushtron, kur si rrjedhojë e zbatimit të ligjit, aktit normativ nënligjor, nga veprimet ose mosveprimet e administratës publike, janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individëve. Këto shkelje duhet të evidentohen në procesin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe njoftimeve që i paraqiten atij.¹

Gjykata Kushtetuese e sheh me vend të ndalet edhe një herë në përcaktimin e konceptit “interes” në çështjen me kërkuet Avokatin e Popullit, sipas nenit 134/2 të Kushtetutës, ku parashikohet se ky organ mund të bëjë kërkesë para kësaj Gjykate vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tij.

Sipas nenit 60 të Kushtetutës, Avokati i Popullit është organ kushtetues i krijuar për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të administratës publike. Një nga mënyrat me të cilat ky organ realizon funksionin e tij është edhe vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e akteve normative të nxjerra nga administrata publike dhe që nga evidentimi i Avokatit të Popullit rezultojnë të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën. Avokati i Popullit mund të arrijë në këtë përfundim përmes hetimeve, vëzhgimeve

¹ Vendim i Gjykatës Kushtetuese V-49/00, datë 31.7.2000, përmbledhja e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese 2000-2001, fq.122.

apo informacioneve që ai mbledh, kur individët i drejtohen atij me anë të ankesës ose kërkesës. Nëse ky organ vlerëson se si rrjedhim i veprimtarisë së administratës publike janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të individit, atëherë ai ndërmerr hapa konkretë për verifikimin e mëtejshëm të shkaqeve që kanë çuar në këtë shkelje dhe rast pas rasti rekomandon marrjen e masave të karakterit normativ, nëse është e nevojshme.

Gjykata Kushtetuese konstaton se kompetenca e Avokatit të Popullit për t'u drejtuar kësaj Gjykate konsiderohet si një garanci shtesë që i është dhënë në mënyrë indirekte individit për të vënë në vend të drejtën e cenuar nga aktet e administratës publike. Nuk është detyra kryesore e Avokatit të Popullit t'i drejtohet gjykatave në tërësi dhe Gjykatës Kushtetuese në veçanti. Megjithatë në legjislacionet e vendeve ku nuk është parashikuar ekzistenca e mjeteve të tilla si kundërshtimi i drejtpërdrejtë i akteve normative para Gjykatës Kushtetuese, Avokati i Popullit mund të luajë një rol të rëndësishëm në verifikimin e shkeljeve të të drejtave themelore të individit deri në investimin e Gjykatës Kushtetuese.² Në raste të tilla, Avokati i Popullit duhet të argumentojë shkeljen konkrete dhe interesin në çështjen që kërkon të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese.

Kur Avokati i Popullit krijon bindjen se shkelja ka ardhur si pasojë e përmbajtjes së një ligji ose akti tjetër normativ, pra nga vetëformulimi i vullnetit të organit që e ka nxjerrë atë, atëherë ai mund ta investojë Gjykatën Kushtetuese duke kërkuar shfuqizimin e aktit si antikushtetues. Në një rast të tillë mund të thuhet se çështja konkrete lidhet me interesin e këtij organi kushtetues për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e individit. Në këtë këndvështrim, interesi i Avokatit të Popullit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me qëllim shfuqizimin si antikushtetues të aktit të ligjvënësit duhet të shqyrtohet rast pas rasti, pasi ky është edhe kuptimi i nenit 134/2 të Kushtetutës, i cili e ka renditur këtë organ në grupin e subjekteve që i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, vetëm nëse justifikojnë interesin e tyre në çështjen konkrete.

Ashtu siç është shprehur edhe në praktikën e mëparshme të kësaj Gjykate, interesi i një subjekti në një çështje në kuptim të shkronjave “dh”, “e”, “ë”, “f” të nenit 134 të Kushtetutës do të quhet i justifikuar, nëse ai arrin të provohet nga vetë kërkuesi se pasoja është e drejtpërdrejtë pra rrjedh direkt nga akti objekt shqyrtimi, është aktuale dhe, sipas rastit, është e lidhur ngushtë me detyrat dhe funksionet e institucionit ose organizatës respektive. Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkuesi i plotëson të tri këto kritere, pasi kërkesa lidhet me përmbajtjen e aktit normativ, i cili, sipas tij, sjell pasoja direkte në një të drejtë kushtetuese themelore siç është e drejta e votës. Gjithashtu, cenimi është aktual dhe jo potencial, pasi, sipas kërkuetit, të burgosurit janë penguar realisht të ushtrojnë të drejtën e votës si rrjedhim i përmbajtjes së dispozitës së nenit 63/3 të Kodit Zgjedhor. Edhe elementi i tretë, pra lidhja e drejtpërdrejtë me subjektin ekziston, pasi, siç u shpreh më lart, është në funksionin e Avokatit të Popullit të mbrojtë interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e administratës publike.

Në kërkesën para kësaj Gjykate kërkuesi ka parashtruar se ai është vënë në lëvizje për këtë shkelje nga vetë të burgosurit, të cilët nuk kanë pasur mundësi të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës. Avokati i Popullit, në ushtrim të kompetencave të veta, ka krijuar mendimin se shkak për mosushtrimin e kësaj të drejte është përmbajtja e dispozitës së Kodit Zgjedhor, eliminimi i së cilës mund të sjellë si pasojë vendosjen në vend të së drejtës së shkelur. Gjykata Kushtetuese çmon se vënia në lëvizje nga Avokati i Popullit është në përputhje me funksionin e tij kushtetues dhe me filozofinë e krijimit të këtij institucioni, si një mekanizëm efektiv në mbrojtje të të drejtave kushtetuese të shtetasve, të drejta të cilat përbëjnë bazën e rendit tonë juridik.

Lidhur me thelbin e kërkesës, pra për të arritur në përfundimin, nëse termi “vendbanim” që përmban dispozita e nenit 63/3 e Kodit Zgjedhor është apo jo në përputhje me Kushtetutën, Gjykata Kushtetuese vlerëson se duhet të ndalet në konceptin e zgjedhjeve në përgjithësi e sidomos te zgjedhjet vendore në veçanti.

E drejta e votës është një nga të drejtat themelore politike që gëzon individi. Kjo e drejtë

² Ky qëndrim ka qenë një nga konkluzionet përfundimtare të Konferencës së Ombudsmanëve të vendeve të Europës Juglindore me temë: Marrëdhëniet ndërmjet ombudsmanëve dhe organeve gjyqësore, organizuar në Lubjanë, Slloveni nga Këshilli i Europës. Janë të njohura ndryshe edhe si “Konkluzionet e Lubjanës”.

ushtrohet nëpërmjet ngritjes së një sistemi zgjedhor që garanton fshehtësinë, lirinë dhe barazinë e votës duke i siguruar shtetasve qenien e tyre politikisht aktiv, duke formuar në këtë mënyrë thelbin e rolit që duhet të kenë ata në një sistem demokratik. E drejta e votës është një element qendror i demokracisë dhe i shtetit të së drejtës. Kontributi kryesor i saj është garantimi i mundësisë për të gjithë zgjedhësit, pa bërë dallime mbi baza shtresash apo përkatësie në grupe të caktuara shoqërore ose mbi baza të tjera, që të ndikojnë në formimin e vullnetit politik në një shoqëri demokratike. Nga ushtrimi i të drejtës së votës nuk duhet përjashtuar asnjë pjesë sado e vogël e popullsisë, përveç rasteve të përcaktuara në ligjin themeltar të shtetit.

Megjithatë e drejta e votës nuk është absolute, ajo mund të bëhet objekt i kufizimeve. Në këtë këndvështrim, për vetë rëndësinë që merr kjo e drejtë në një shoqëri demokratike, kufizimet që i duhen bërë kësaj të drejte jo vetëm duhet të jenë të pakta, por ato duhen zbatuar brenda kufijve kushtetues.³ E rëndësishme është që kufizimet të mos jenë të tilla që ta bëjnë jo efektiv ushtrimin e kësaj të drejte ose ta cenojë atë në thelbin e saj,⁴ pasi e drejta e votës nuk është një privilegj që pushteti shtetëror ua njeh shtetasve, por një instrument për të zgjedhur mënyrën dhe personat që do të qeverisin vetë ata. Duke ushtruar të drejtën e votës zgjedhësit i krijohet mundësia të ndikojë në mënyrën dhe cilësinë e funksionimit të rendit juridik, duke e bërë shtetasin më të përgjegjshëm për rolin që ai ka në drejtimin e jetës së vendit. Ky është në fakt edhe thelbi i demokracisë.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 45 të saj, parashikon të drejtën e çdo individi mbi 18 vjeç të zgjedhë e të zgjidhet. Përjashtim bëjnë personat të cilëve u është hequr kjo e drejtë me vendim gjyqësor të formës së prerë për paaftësi mendore. Gjithashtu, paragrafi 3 i këtij neni parashikon se të dënuarit që janë duke vuajtur dënimin me heqje të lirisë kanë vetëm të drejtën për të zgjedhur. Ky parashikim kushtetues është brenda standardeve demokratike dhe bashkëkohore.

Gjykata Kushtetuese thekson se teoria e së drejtës kushtetuese, si dhe praktika gjyqësore europiane e quan të pranueshme dhe të justifikuar vendosjen e kriterëve të tilla si, mosha minimum ose vendbanimi në një zonë të caktuar, përfshirja në lista zgjedhësish apo pasja e shtetësisë së vendit ku zhvillohen zgjedhjet, si dhe aftësia mendore për të shprehur vullnetin politik. Duke iu referuar edhe praktikës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut dispozita e nenit 1, protokollit nr.3 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, vendet anëtare kanë një hapësirë të gjerë në hartimin e legjisllacioneve të tyre për zgjedhjet, natyrisht duke respektuar thelbin e së drejtës. Kufizimet që mund t'i vendosen kësaj të drejte duhet t'i përgjigjen një qëllimi legjitim dhe të mos jenë arbitrare apo joproporcionale.⁵

Neni 45/3 i Kushtetutës sonë ka shkuar tej parashikimeve minimale si detyrime që rrjedhin dhe nga aktet ndërkombëtare.⁶ Këto akte, që synojnë garantimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike, u lënë shteteve anëtare një hapësirë të gjerë vlerësimi të mekanizmave që kanë në dispozicion për ta bërë ushtrimin e të drejtës së votës efektive edhe për grupe të posaçme.⁷ Në këtë aspekt i është lënë vetë shteteve anëtare të vlerësojnë, midis të tjerave, edhe grupet e individëve që mund të përjashtohen nga e drejta e votës, p.sh., vendosja e një moshe më të lartë për të ushtruar të drejtën e votës ose vendosja e kriterëve të tilla si shtetësia.

Në rastin konkret, ligjvënësi ynë ka vendosur minimumin e kriterëve kufizues duke u njohur të burgosurve të drejtën aktive të zgjedhjes. Pra, nga pikëpamja e garancisë kushtetuese formale e drejta e votës së të burgosurve është arritur nga dispozita e nenit 45/3 të Kushtetutës. Parashikimi i të drejtës së votës në përgjithësi dhe i grupeve të posaçme, siç konsiderohen të burgosurit, në veçanti, është shprehje e një demokracie politike dhe paraqet rëndësi për pjesëmarrjen e gjerë të votuesve në një proces të rëndësishëm.

Gjykata Kushtetuese konstaton se neni 63 i Kodit Zgjedhor vendos rregullat e ushtrimit të së drejtës së votës për të burgosurit në zbatim të detyrimit që rrjedh nga dispozita e nenit 45/3 të

³ Vendim i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, *Aziz kundër Qipros*, nr.69949/01 (2004).

⁴ Vendime të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, *Matthews kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.24833/94, (1999); *Labita kundër Italisë* nr.26772/95, (2000).

⁵ Vendimi cituar më lart *Labita kundër Italisë*.

⁶ Shih nenin 3 të protokollit nr.1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe nenit 25 të paktit për të Drejtat Civile dhe Politike të OKB-së.

⁷ *Frowein/Peukert*, *Europäische Menschenrechtskonvention-Kommentar* (1996) fq. 838.

Kushtetutës. Konkretisht, paragrafi 2 i nenit 63 parashikon votimin për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, kurse paragrafi 3 i këtij neni i referohet votimit në zgjedhjet për pushtetin vendor. Një nga dallimet midis këtyre dy dispozitave është se për zgjedhjet vendore ligjvënësi e ka lidhur ushtrimin e të drejtës së votës me vendbanimin, ndërsa për zgjedhjet e përgjithshme jo. Arsyeja e këtij dallimi duhet kërkuar te fakti se në zgjedhjet e përgjithshme votohet për anëtarët e organit ligjvënës, të cilët i përkasin të gjithë popullit. Një nga parimet kryesore të përfaqësimit popullor është edhe mungesa e mandatit detyrues të deputetit, pra deputeti përfaqëson jo zonën zgjedhore ku ai votohet, por të gjithë zgjedhësit.

Ndryshe ndodh në rastin e zgjedhjeve vendore. Këtu synohet një lidhje më e ngushtë midis zgjedhësit dhe të zgjedhurit për vetë natyrën e organizimit dhe kompetencave të pushtetit lokal. Është pushteti vendor që kujdeset për zgjidhjen e problemeve aktuale të qytetarëve që lidhen me çështje të tilla, si punësimi, kujdesi shëndetësor, arsimi parashkollor, pastrimi dhe gjelbërimi i mjediseve të njësisë vendore etj. Për këtë arsye, votimi në zgjedhjet vendore trajtohet si pjesë e strukturës së demokracisë nga poshtë lart, duke u mundësuar zgjedhësve pjesëmarrjen në qeverisje edhe në forumet më të vogla, përveç parlamentit kombëtar.⁸ Në këtë këndvështrim, pranohet se pushteti lokal është më afër qytetarëve dhe këta të fundit janë më të ndjeshëm ndaj ndryshimeve në drejtimin e njësisë vendore ku ata kanë vendbanimin.

Sipas nenit 12 të Kodit Civil, banimi është "...vendi ku personi, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë apo të realizimit të interesave të veta, qëndron zakonisht ose të shumtën e kohës." Në këtë kuptim, vendbanimi është pika qendrore e marrëdhënieve jetësore të një njeriu. Është kërkesë ligjore që një person të ketë një vendbanim kryesor, brenda një juridiksioni të caktuar, me qëllim që të votojë, të punësohet ose të presë përfitime të tjera brenda këtij juridiksioni. Kushti për të pasur vendbanimin në zonën zgjedhore është një nga kufizimet e të drejtës së votës, e cila bashkë me kriterin e shtetësisë synojnë të vendosin një lidhje direkte, qoftë edhe minimale, midis votuesit dhe rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Në këtë mënyrë sigurohet legjitimiteti i votës në një zonë të caktuar.⁹

Në këtë këndvështrim, duket me vend që neni 63/3 i Kodit Zgjedhor e lidh ushtrimin e të drejtës së votës për të burgosurit me konceptin e vendbanimit dhe jo me vendin e vuajtjes së dënimit ose vendqëndrimin. Gjykata Kushtetuese çmon se kushtëzimi i të drejtës së votës me konceptin e "vendbanimit" në përmbajtjen e dispozitës së nenit 63/3 të Kodit Zgjedhor nuk e bën atë antikushtetuese, përkundrazi ai garanton shprehjen direkte të vullnetit të zgjedhësit për drejtuesit e njësisë vendore ku ai banon.

Si përfundim, në vijim të arsyetimit të mësipërm, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata Kushtetuese konstaton se mosushtrimi i të drejtës së votës nga të burgosurit dhe të paraburgosurit nuk është rrjedhojë e antikushtetutshmërisë së dispozitës së nenit 63/3 të Kodit Zgjedhor.

Për arsyet e paraqitura më lart, Gjykata Kushtetuese çmon se dispozita e paragrafit 3 të nenit 63 të Kodit Zgjedhor është në përputhje me nenin 45/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 49/2 e 51 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: V.Kristo (kryetar), F.Abdiu, Gj.Sauli, P.Ploçi, K.Puto, K.Peçi, Xh.Zaganjori, S.Sadushi.

Anëtar kundër: S.Berberi.

⁸ Klaus Stern, Das Staatsrecht der Bundesrepublik Deutschland, fq.424.

⁹ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë, BVerfGE 36, 139/142.

VENDIM
Nr.41, datë 16.11.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	kryetar i Gjykatës Kushtetuese,
Gjergji Sauli	anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	anëtar i “ “
Kristofor Peçi	anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	anëtar i “ “
Petrit Plloçi	anëtar i “ “
Sokol Sadushi	anëtar i “ “
Sokol Berberi	anëtar i “ “
Kujtim Puto	anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datë 9.5.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.38 Akti, që i përket:

KËRKUES: Organizata Kombëtare për Dëshmorët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe Dëshmorët e tjerë të Atdheut, përfaqësuar nga avokat Xhemali Hasa, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj, me autorizim.
2. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Enkelejd Alibeaj, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i ligjit nr.9650, datë 27.11.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8607, datë 27.4.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, i ndryshuar”.

Kërkuesi ka paraqitur këto shkaqe për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të ligjit objekt kërkesë:

- Pjesëtarët e familjeve të dëshmorëve e kanë fituar të drejtën e shpërblimit në bazë të ligjit dhe nuk mund t’u hiqet me një ligj tjetër, sepse cenohet parimi i sigurisë juridike dhe i të drejtave të fituara;

- Ligji, objekt gjykimi, i ka dhënë kompetencë veç këshillit të qarkut edhe prefektit të verifikojë, të shqyrtojë dhe të propozojë në Komisionin Qendror për shpalljen e dëshmorëve të atdheut, megjithëse juridikisht nuk mund të jenë dy organe kompetente për të njëjtin problem;

- Ligji i ri i ka dhënë të drejtë kërkuesve për shpalljen dëshmor që t’u drejtohen gjykatës, nëse këshilli i qarkut ose Komisioni Qendror nuk shqyrton kërkesën për shpalljen dëshmor brenda afateve ligjore. Përfshirja e gjykatave në procesin e përgatitjeve për marrjen e vendimit është antikushtetuese, sepse i vendos ato në varësi të administratës.

Përfaqësuesit e subjekteve të interesuara pretenduan:

- Ligji, objekt shqyrtimi, bën përcaktimin korrekt të pjesëtarëve të familjes. Ky përcaktim bëhet vetëm për efekt të shpërblimit dhe jo për të mosrespektuar të drejtat e familjarëve e të afërmeve dhe nderimet që u bëhen atyre;

- Pagesa 5 000 lekë në muaj ka efekte simbolike. Ai është i pakushtëzuar dhe nuk destinohet për përdorim në një drejtim të caktuar. Familjarët nuk janë të detyruar ta përdorin atë për organizim ceremonish përkujtimore, mirëmbajtje përmendoresh, të varrit apo lapidarit, sepse ligji ka ngarkuar për këto organet shtetërore dhe ato të qeverisjes vendore;

- Dhënia e të drejtës së propozimit për shpallje dëshmor edhe prefektit garanton më shumë të drejtën e personave kërkues;

- Është organi ligjvënës që vlerëson, nëse një rregullim të caktuar do ta bëjë me ligj apo do t’ia delegojë Këshillit të Ministrave;

- Ligji i ri nuk cenon pavarësinë e gjykatave, por vendos autoritetin administrativ nën kontrollin gjyqësor për të garantuar një mbrojtje maksimale të interesave të kërkuesve për dhënien e

statusit të dëshmorit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puton, përfaqësuesin e kërkuar që kërkonte pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjekteve të interesuara që kërkonin rrëzimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr.9650, datë 27.11.2006 ka bërë disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.8607, datë 27.4.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”. Me shtesat dhe ndryshimet e bëra është parashikuar që të drejtën për t’i propozuar Komisionit Qendror të Statusit të Dëshmorit të Atdheut njohjen e statusit të dëshmorit ta ketë, përveç këshillit të qarkut edhe prefekti (neni 3); është parashikuar e drejta e ankimit në gjykatë në rast mosshqyrtimi të kërkesës nga këshilli i qarkut ose prefekti, si dhe në rast mosshqyrtimi të propozimit nga Komisioni Qendror i Statusit të Dëshmorit të Atdheut. Me këto shtesa e ndryshime është kufizuar, gjithashtu numri i subjekteve që përfitojnë shpërblimin simbolik prej 5 000 lekë në muaj.

Në ligjin nr.8607, datë 27.4.2000, njohja e Statusit të Dëshmorit të Atdheut kalonte nëpërmjet kërkesës që familja e dëshmorit, organet shtetërore ose përfaqësuesit e shoqërisë civile i bënte këshillit të qarkut për shpalljen “Dëshmor i Atdheut” dhe nëpërmjet propozimit që këshilli i qarkut i bënte Komisionit Qendror të Statusit të Dëshmorit të Atdheut për njohjen e këtij statusi. Ndryshimet në ligjin objekt shqyrtimi nuk cenonin fazat e procedimeve, por krahas këshillit të qarkut i japin të drejtë prefektit të bëjë edhe ai propozim për shpalljen dëshmor.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se dhënia e së drejtës për të bërë propozim për shpalljen “Dëshmor i Atdheut” edhe prefektit nuk cenon parimet kushtetuese e ligjore që rregullojnë qeverisjen vendore, pasi njohja e Statusit të Dëshmorit të Atdheut është një çështje me rëndësi jo vetëm lokale, por edhe kombëtare, e cila, në disa raste, mund të zgjidhet më mirë me iniciimin e procesit nga organet e pushtetit qendror, përfaqësuesit e cilëve është prefekti.

Nga ana tjetër, dhënia e kompetencës për të bërë propozim për shpalljen “dëshmor” edhe prefektit nuk kufizon kompetencat e organeve të pushtetit vendor. Kjo e drejtë zgjeron vetëm rrethin e subjekteve që kanë të drejtë të iniciojnë një procedurë administrative për njohjen e këtij statusi nga Komisioni Qendror i Statusit të Dëshmorit të Atdheut, i cili mbetet i vetmi organ vendimmarrës. Dhënia e kësaj kompetente edhe institucionit të prefektit, nuk cenon as të drejtat e shoqatës dhe të anëtarëve të saj, por është një mundësi më shumë për të garantuar të drejtat e personave kërkuar, të cilët, sipas nenit 3 të ligjit nr.8607, datë 27.04.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, janë familjarët e dëshmorit, organet shtetërore ose përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Nenet 2 dhe 3 të ligjit nr.9650, datë 27.4.2006 që kanë ndryshuar nenet 4 dhe 5 të ligjit nr.8607, datë 27.4.2000, kanë vendosur afate për përfundimin e këtyre procedimeve dhe kanë parashikuar të drejtën e ankimit në gjykatë në rast mosshqyrtimi brenda këtyre afateve të kërkesës apo propozimit për shpalljen dëshmor.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se njohja me ligj e të drejtës së ankimit në gjykatat e sistemit gjyqësor për mosshqyrtimin brenda afateve nga organi administrativ, nuk përbën cenim të parimit kushtetues të garantimit të pavarësisë së gjykatave. Kontrolli gjyqësor mbi administratën publike bazohet në parimet kushtetuese të balancimit të pushteteve (neni 7) dhe të shtetit të së drejtës (neni 4) dhe është sanksionuar si parim procedural edhe në Kodet e Procedurave Administrative e Civile. Pikërisht në nenet 324, 328 e 331 të Kodit të Procedurës Civile është parashikuar e drejta për të ngritur padi në gjykatë edhe në rastin e mosshqyrtimit të kërkesës nga ana e administratës publike brenda afateve ligjore. Në këtë mënyrë, ligjvënësi për të garantuar një mbrojtje më të mirë të interesave të kërkuarve për dhënien e statusit të dëshmorit, vendos autoritetin administrativ nën kontrollin gjyqësor.

Me ligjin nr.8607, datë 27.4.2000, përfitonin bashkërisht, një shpërblim financiar mujor prej 5 mijë lekësh, bashkëshorti i dëshmorit, fëmijët pa kufizim moshe, prindërit, vëllezërit dhe motrat, ndërsa me ndryshimet e bëra nga kjo e drejtë nuk përfitojnë fëmijët mbi 18 vjeç (ose mbi 25 vjeç, kur vazhdojnë shkollën), prindërit që nuk bashkëjetojnë me të në momentin e vdekjes, si dhe vëllezërit dhe motrat që nuk kanë qenë në kujdestari të tij.

Gjykata Kushtetuese, arrin në përfundimin se bërja e këtij ndryshimi, ndonëse mund të cenojë një të drejtë të mëparshme, nuk përbën cenim të parimeve, të të drejtave të fituara e të besimit të qytetarëve të sistemi juridik që të gëzojnë mbrojtje kushtetuese. Kushtetuta nuk ndalon çdo ndryshim të një situate të favorshme ligjore. Kështu, në këtë drejtim, duhet parë në çdo rast se në çfarë mase dhe deri ku, besimi që ka qytetari në situatën e favorshme ligjore paraqitet i rëndësishëm për t'u mbrojtur nga normat dhe parimet kushtetuese, si dhe cilat janë arsyet për një mbrojtje të tillë.

Ligjvënësi ka detyrimin t'i rregullojë në mënyrë më të hollësishme të drejtat e parashikuara në Kushtetutë. Në kuadrin e këtij rregullimi, ai nuk mund të prekë ato të drejta, kufijtë e të cilave në Kushtetutë janë parashikuar shprehimisht si të pakapërcyeshme ose të kufizueshme vetëm në raste specifike. Të drejtat e tjera kushtetuese ai mund t'i kufizojë vetëm në kushtet e nenit 17 të Kushtetutës, pra, për një interes publik, për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve me mënyra dhe forma që të jenë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar ndryshimin dhe pa prekur thelbin e të drejtës. Përsa i përket masave të tjera që merr ligjvënësi, qofshin edhe ato me efekte negative për subjektet e ligjit, nuk mund të pranohet se kufizimi i tyre sjell në çdo rast cenimin e parimit kushtetues të mbrojtjes së të drejtave të fituara.

E drejta për shpërblim financiar mujor të familjarëve të dëshmorit nuk është një e drejtë themelore e parashikuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë apo konventat ndërkombëtare dhe as një e drejtë që derivon nga ligje që janë zbatim i të drejtave themelore të qytetarëve. Ajo nuk rrjedh as nga e drejta e sigurimeve shoqërore dhe rrjedhimisht, kushtet e dhënies e të ndryshimit të saj nuk mund të barazohen me të drejtën e përfitimit të pensioneve si një e drejtë themelore, parashikuar në nenin 52 të Kushtetutës.

Shpërblimi financiar mujor i familjarëve të dëshmorit ka karakter simbolik dhe është pjesë e nderimit dhe e respektit që shteti bën për veprën e dëshmorit, prandaj masa e tij, si dhe rrethi i subjekteve që përfitojnë vlerësohen nga ligjvënësi.

Gjykata Kushtetuese çmon se ligjvënësi, sipas vlerësimit e kompetencave të veta, ka vlerësuar që nderimi dhe respekti për dëshmorët do të bëhet nëpërmjet organizimit të ceremonive përkujtimore nga organet shtetërore dhe duke ngritur e mirëmbajtur varrezat, lapidaret etj. Organet shtetërore kanë detyrë, gjithashtu të ruajnë e mirëmbajnë në muze dokumentet e dëshmorëve dhe t'u japin përparësi familjarëve të dëshmorëve për strehim e punësim. Në kuadrin e këtij nderimi e respekti, ligjvënësi cakton, për një rreth të kufizuar të familjarëve të dëshmorit, një shpërblim simbolik.

Rregullimi i mësipërm edhe për shpërblimin simbolik, i sanksionuar me ligj, nuk mund të vlerësohet si cenim i parimit të sigurisë juridike jo vetëm se nuk cenon një të drejtë themelore, por nuk ka të bëjë as me të drejta që të jenë një zbatim i të drejtave themelore. Në lidhje me këtë, edhe rezoluta e miratuar nga OKB-ja, nr.2200 XXII, dhjetor 1966 "Pakti ndërkombëtar lidhur me të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore", të cilës i referohet kërkuesi, merr në mbrojtje të drejtat themelore të njeriut dhe jo çdo të drejtë kur thekson se "nuk mund të pranohet asnjë kufizim ose shkelje e të drejtave themelore të njeriut që janë njohur, ose janë në fuqi në çdo vend në bazë të ligjeve, konventave, rregulloreve, ose zakoneve".

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: V.Kristo (kryetar), P.Plloçi, Xh.Zaganjori, K.Peçi, K.Puto.

Anëtarë kundër: F.Abdiu, Gj.Sauli, S.Berberi, S.Sadushi.

MENDIMI I PAKICËS

Pjesërisht jam kundër qëndrimit të shumicës.

- Në ligjin nr.8607, datë 27.4.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, e drejta e shpërblimit financiar mujor i përkiste bashkëshortit ose bashkëshortes, fëmijëve, prindërve, vëllezërve dhe motrave, bashkërisht në mënyrë të barabartë papërblyer, ndërsa në ligjin nr.9650, datë 27.11.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8607, datë 27.4.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, i ndryshuar”, kjo e drejtë i përket vetëm bashkëshortit/bashkëshortes, fëmijëve nën 18 vjeç ose deri në 25 vjeç, kur kryejnë studimet e larta, prindërve bashkëjetues dhe personave në kujdestari, sipas certifikatës së gjendjes familjare në çastin e vdekjes së Dëshmorit të Atdheut. Ky shpërblim ndërpritet kur familjari nuk plotëson kushtet e përcaktuara më sipër që tërhiqet nga kryefamiljari i Dëshmorit të Atdheut, ose në rast mosmarrëveshje, kur është më shumë se një person, nga secili sipas pjesës që i përket.

Kërkuesi në kërkesën e tij ka kërkuar shfuqizimin e nenit 4 të ligjit nr.9650, datë 27.11.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8607, datë 27.4.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, i ndryshuar”.

Sipas kërkuesit neni 4 i ligjit nr.9650, datë 27.11.2006, cenon një të drejtë të fituar me ligjin nr.8607, datë 27.4.2000, pasi u heq të drejtën e shpërblimit financiar mujor fëmijëve mbi 18 vjeç ose mbi 25 vjeç, kur ata kryejnë studimet e larta, prindërve, vëllezërve dhe motrave që nuk bashkëjetojnë ose nuk janë nën kujdestari, sipas certifikatës së gjendjes familjare në çastin e vdekjes së Dëshmorit të Atdheut. Ky cenim bie në kundërshtim me nenet 4, 15 dhe 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; rezolutën nr.2200 XXII, dhjetor 1966, të miratuar nga OKB-ja, si dhe me vendimet dhe qëndrimet e mbajtura nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, mbi parimin e shtetit të së drejtës dhe sigurisë juridike dhe ky cenim nuk rezulton të jetë bërë për një interes publik ose në mbrojtje të të drejtave të të tjerëve.

Për mendimin tim, qëndrimi i shumicës është në kundërshtim me praktikën e qëndrueshme të Gjykatës Kushtetuese.

Doktrina e së drejtës kushtetuese ka pranuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësorë të shtetit të së drejtës. Kjo siguri presupozon veç të tjerave besueshmërinë e qytetarëve te shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me faktin se qytetari nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve normative që cenojnë dhe përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Sipas Gjykatës Kushtetuese, “... nuk do të kishim të bënim me një rast të garantimit të besueshmërisë në sistemin e normave juridike, nëse siguria lidhur me një situatë të caktuar juridike nuk mund të justifikohet dhe nuk mund të mbrohet materialisht”.¹⁰

Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë, ose për pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private, ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme.

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Shqipërisë, konceptin e sigurisë juridike, të së drejtës së fituar, të pritshmërisë së ligjshme dhe të besimit të qytetarëve te shteti, i referon te parimi i shtetit të së drejtës. Ky parim është sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës dhe duhet kuptuar e interpretuar në lidhje të ngushtë me aspiratën e shprehur në Preambulën e Kushtetutës, ku është skalitur vendosmëria e popullit shqiptar “... për të ndërtuar shtetin e së drejtës, demokratik e social”. “Shteti i së drejtës, i cili garantohet që në Preambulën e Kushtetutës, është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Si i tillë, ai përbën një normë të pavarur kushtetuese, prandaj shkelja e tij përbën në vetvete bazë të mjaftueshme për deklarimin e një ligji si antikushtetues”.¹¹

Pra, rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Si rregull, nuk mund të mohohen interesat dhe pritshmëritë ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion dhe shteti duhet të synojë të ndryshojë një

¹⁰ Shih vendimin nr.26, datë 2.11.2005 të Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Shqipërisë.

¹¹ Shih vendimin nr.34, datë 20.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Shqipërisë.

situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive, konkretisht, trajtim më të mirë financiar për subjektet përfituese.

Sanksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të pranuar në Kushtetutë dhe shoqërimi i tyre me masat për vënien në jetë të tyre duhet të synojnë përmirësimin dhe rritjen e standardeve të të drejtave, forcimin e shtetit ligjor. Nëse masat e marra shpien në përkeqësimin në mënyrë të paarsyeshme të gjendjes ligjore të personave të tjerë, mohojnë të drejtat e fituara ose injorojnë interesat legjitime të këtyre, atëherë do të dhunohet parimi kushtetues i barazisë së të drejtave dhe, në përgjithësi, do të rrezikohet arritja e qëllimit madhor të ndërtimit të shtetit të së drejtës.¹²

Sipas praktikës së Gjykatës Kushtetuese mbrohen nga parimi i sigurisë juridike jo vetëm të drejtat dhe liritë themelore të njohura dhe të sanksionuara në Kushtetutë, por edhe të drejtat subjektive materiale të individëve të njohura nga ligje të zakonshme.

Ndryshimi që neni 4 i ligjit nr.9650, datë 27.11.2006, i bën neni 14 të ligjit nr.8607, datë 27.4.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, i ndryshuar”, në fakt cenon të drejtën për shpërblim financiar mujor që ky i fundit ia njihte edhe fëmijëve pa dallim moshe, prindërve edhe jo bashkëjetues dhe motrave dhe vëllezërve që nuk ishin në kujdestari të Dëshmorit të Atdheut, në çastin e vdekjes së tij.

E drejta për shpërblim financiar mujor e parashikuar nga ligji nr.8607, datë 27.4.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, i ndryshuar”, është një e drejtë subjektive materiale ligjore. Ajo duke qenë e shprehur në terma monetare konsiston në një shumë fikse simbolike, ka karakter moralo-patriotik dhe ka për qëllim të nderojë dhe respektojë pjesëtarët e familjes së Dëshmorit të Atdheut, për gjakun dhe jetën që ata kanë dhënë dhe japin për mbrojtjen e integritetit territorial të atdheut, institucioneve shtetërore të tij, paqen, lirinë dhe jetën e individit. Si e tillë, kjo e drejtë nuk rrjedh nga sigurimet shoqërore dhe rrjedhimisht kushtet e përfitimit të saj nuk mund detyrimisht të barazohen me kushtet e përfitimit të pensioneve familjare, të parashikuara në nenin 40 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ashtu siç dëshiron të bëjë neni 4 i ligjit nr.9650, datë 27.11.2006 që në fakt kufizon kushtet e përfitimit të së drejtës për shpërblim financiar mujor të parashikuar nga neni 14 i ligjit nr.8607, datë 27.4.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, i ndryshuar”.

Siguria juridike, të drejtat e fituara me ligj mund të preken, kur është fjala për të mbrojtur një interes publik, por në gjykimin e çështjes nuk u paraqitën e nuk u konstatuan shkaqe ose motive që justifikojnë domosdoshmërinë e cenimit të kësaj të drejte.

Sa parashtrova, mendoj se përderisa neni 4 i ligjit nr.9650, datë 27.11.2006 që ndryshon nenin 14 të ligjit nr.8607, datë 27.4.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, i ndryshuar”, nuk është rezultat i një interesi publik, ai prek parimin e sigurisë juridike dhe si e tillë, kjo dispozitë është antikushtetuese e duhet të shfuqizohet.

Anëtar: F.Abdiu.

VENDIM

Nr.10, datë 12.9.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Thimjo Kondi	kryetar
Artan Hoxha	anëtar
Gani Dizdari	anëtar
Ylvi Myrtja	anëtar
Nikoleta Kita	anëtare
Agron A.Lamaj	anëtar
Spiro Spiro	anëtar

¹² Shih vendimin nr.9, datë 26.2.2007 të Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Shqipërisë.

Perikli Zaharia	anëtar
Evjeni Sinoimeri	anëtare
Irma Bala	anëtare
Ardian Dvorani	anëtar
Besnik Imeraj	anëtar
Fatos Lulo	anëtar
Ardian Nuni	anëtar

në seancën gjyqësore të datës 12.9.2007, mori në shqyrtim çështjen civile që i përket:

PADITËS: Jorgji Kore, përfaqësuar nga av.Genc Cifligu.

E PADITUR: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, përfaqësuar nga juristët Ervina Domi e Shamet Shabani.

OBJEKTI I PADISË: Detyrimin e palës së paditur, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të më shpërblejë dëmin për shkak të zgjidhjes së menjëhershme dhe pa shkaqe të kontratës së punës nga punëdhënësi në masën 20 e ½ të pagave mujore, si dhe rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës.

BAZA LIGJORE: Nenet 144, 145, 146, 155 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar), pika 19 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.172, datë 29.3.2006 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.4.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, (i ndryshuar)”, nenet 32 dhe 153 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me vendimin nr.2340, datë 2.4.2007 ka vendosur:

Nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor të çështjes civile me nr.709 akti.

Kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, në bazë të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, kanë ushtruar ankim të veçantë pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si dhe pala paditëse, Jorgji Kore, të cilët kërkojnë prishjen e këtij vendimi dhe kthimin e çështjes për vazhdimin e gjykimit në këtë Gjykatë, duke parashtruar shkaqet e mëposhtme:

Shkaqet e parashtruara në ankimin e të paditurit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave:

- Gjykata ka gabuar në përfundimin e arritur, duke iu referuar Kodit Doganor, se nëpunësi doganor i kategorisë C2 gëzon statusin e nëpunësit civil, pasi sipas nenit 2 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit të shërbimit civil” punonjësit e doganës nuk përfshihen në nëpunës të shërbimit civil.

- I gabuar është dhe referimi që gjykata iu bën vendimeve të Këshillit të Ministrave me nr.686, datë 2.11.2005, nr.172, datë 29.3.2006 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.4.1999”, pasi dihet se rregullimi i marrëdhënieve të punës bëhet me ligj, që në rastin konkret me dispozita të Kodit Doganor dhe që parashikon Kodin e Punës dhe jo ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

- Nëse do t’i referoheshim dispozitave përkatëse të Kodit Doganor, në asnjë dispozitë të tij nuk gjejmë të përcaktuar shprehimisht, madje as në kuptim të gjerë të tij, se nëpunësi doganor gëzon statusin e nëpunësit civil.

- Dhe po t’i referohemi nenit 14 të Kodit Doganor, nuk mund të mos konstatojmë se ligjvënësi në këtë dispozitë nuk ka përcaktuar se nëpunësi i administratës doganore përfshihet në punonjës me status të shërbimit civil, për më tepër që ligji të cilit i referohet kjo dispozitë e Kodit Doganor, është shfuqizuar aktualisht.

Shkaqet e parashtruara në ankimin e paditësit Jorgji Kore:

- Vendimi i gjykatës për nxjerrjen jashtë juridiksionit të padisë së ngritur nga paditësi Jorgji Kore, është një vendim i marrë në interpretim të gabuar të ligjit dhe konkretisht të dispozitave të cilat rregullojnë marrëdhëniet e punës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe të degëve të saj vartëse.

- Të gabuara janë dhe arsyetimet e gjykatës që mbështetet në nenet 13/2, 3 dhe 14 të Kodit Doganor, në një kohë në asnjë nga këto nuk përcaktohet që personeli gëzon statusin e nëpunësit civil, por vetëm që rekrutimi i këtij personeli bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara në ligjin “Për shërbimin civil”.

- Gjykata duhej të kishte pasur parasysh ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit

civil”, pasi është ky ligj që përcakton se cilët persona gëzojnë këtë status dhe mbi cilat institucione ky ligj shtrin fushën e veprimit të tij dhe është neni 3 që e përcakton.

- Në vendimet e Këshillit të Ministrave që kanë dalë në zbatim të Kodit Doganor, që është një ligj i posaçëm mbi bazën e të cilit rregullohen dhe marrëdhëniet e punës së personelit doganor, ku është rregulluar dhe procedura e largimit të nëpunësve të nivelit C2 në doganë, që nuk është e njëjtë me procedurën e përcaktuar në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 3.7.2007 ka vendosur:

“Dërgimin e çështjes për gjykim Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me qëllim unifikimin e praktikës gjyqësore”.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relacionin e gjyqtarëve Ardian Dvorani dhe Evjeni Sinoimeri, mbrojtjen e përfaqësuesit të palës paditëse, avokatin Genc Cifligu, që kërkoi prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë dhe dërgimin e çështjes në atë Gjykatë për vazhdimin e gjykimit, mbrojtjen e përfaqësuesve të palës së paditur, juristët Ervina Domi e Shamet Shabani, që kërkuan prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe dërgimin e çështjes në atë Gjykatë për vazhdimin e gjykimit, dhe pasi biseduan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

Vendimi nr.2340, datë 2.4.2007 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë me të cilin është nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor çështja civile me palë paditëse Jorgji Kore dhe të paditur Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, me objekt kundërshtimin e aktit administrativ të largimit nga puna të paditësit dhe zgjidhjen e pasojave që rrjedhin prej tij, duhet të priset për zbatim të gabuar të ligjit dhe çështja duhet të dërgohet pranë asaj Gjykate për vazhdimin e gjykimit.

Rezulton nga vendimi i gjykatës së faktit dhe aktet e administruara gjatë shqyrtimit të çështjes objekt gjykimi se, paditësi Jorgji Kore ka qenë në marrëdhënie pune pranë palës së paditur me detyrë doganier i verifikimit në degën e doganës Gjirokastrë. Ky pozicion pune i përket kategorisë C2 “nëpunës civil ekzekutues”, sipas dispozitave të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” dhe atyre akteve nënligjore të nxjerra në bazë e për zbatim të tij.

Me urdhrin nr.4877/12, datë 8.5.2006 të palës së paditur është vendosur që ndaj paditësit të jepet masa disiplinore e “largimit nga puna” me motivacionin “për marrje pjesë aktive në fushatën elektorale”. Sipas përmbajtjes së urdhrin, ky akt motivohet dhe gjen mbështetje në kryerjen e veprimeve të lartpërmendura, si akte që vijnë në kundërshtim me Kodin e Etikës në Shërbimin Doganor (pikat 7, 7.1 dhe 7.2), me urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave nr.3619, datë 24.5.2002 “Mbi kodin e sjelljes në zgjedhjet parlamentare 2005”, atij me nr.4028, datë 9.6.2005, me ligjin nr.9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, me dispozitat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.686, datë 2.11.2005 që ka ndryshuar vendimin e Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.4.1999, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.305, datë 13.6.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”.

Paditësi e kundërshton gjyqësisht urdhrin me të cilin i është dhënë masa disiplinore e largimit nga puna, duke u mbështetur jo vetëm në Kodin e Punës, por, ndërmjet të tjerash edhe në pikën 19 të kreut VI, titulli II, pjesa I të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.172, datë 29.3.2006, sipas së cilës: “kundër vendimeve disiplinore të administratës doganore mund të ushtrohet ankim në gjykatën e rrethit brenda 30 ditëve nga komunikimi i vendimit”.

Në vijim të gjykimit të çështjes, mbështetur në nenin 59 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata e faktit, kryesisht, ka marrë në shqyrtim, nëse kjo çështje bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo në atë administrativ. Gjykata e faktit ka arritur në përfundimin se paditësi nuk duhet të ngrinte padi drejtpërdrejt në gjykatën e shkallës së parë, sepse paraprakisht duhet të ezaurojë rrugën administrative të ankimimit të aktit administrativ objekt shqyrtimi, duke iu drejtuar Komisionit të Shërbimit Civil. Në këtë përfundim, gjykata e faktit ka arritur, pasi ka çmuar se paditësi nuk është punonjës i zakonshëm i administratës doganore, por gëzon statusin e nëpunësit civil, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga ky status.

Sipas gjykatës së faktit, paditësi është marrë në punë mbi bazën e konkurrit, ashtu siç

parashikon Kodi Doganor (neni 14/2), si dhe ligji nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”. Lidhur me dispozitat e vendimit nr.172, datë 29.3.2006 të Këshillit të Ministrave, i cili parashikon ankimin e drejtpërdrejtë në gjykatë për këtë kategori punonjësish, gjykata argumenton se, në hierarkinë e akteve normative ligjet qëndrojnë mbi aktet normative të Këshillit të Ministrave dhe, për rrjedhojë, këto të fundit nuk duhet të vijnë në kundërshtim me ligjet. Gjykata ka konstatuar se ky akt vjen në kundërshtim me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” që parashikon një procedurë të ndryshme ankimi, ndaj dhe nuk duhet të merret në konsideratë.

Ndaj vendimit të gjykatës së faktit kanë bërë ankim të veçantë të dyja palët ndërgjyqëse, të cilat pretendojnë se të gjithë punonjësit e administratës doganore nuk përfshihen në kategorinë e nëpunësve të shërbimit civil të parashikuar nga dispozitat e ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.4.1999, i ndryshuar me vendimin nr.686, datë 2.11.2005, si dhe aktet e tjera nënligjore të dala për zbatim të Kodit Doganor, nuk bëjnë rregullimin e marrëdhënieve të punës. Rregullimi i këtyre të fundit bëhet me ligj që në rastin konkret është Kodi Doganor, për aq sa ai shprehet, dhe Kodi i Punës.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke vlerësuar rëndësinë e pretendimeve të parashtruara në ankimet e veçanta të të dyja palëve ndërgjyqëse, si dhe duke çmuar se praktika gjyqësore, në gjykatat më të ulëta, ashtu edhe në kolegjet e veçanta të Gjykatës së Lartë, jo vetëm pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave nr.172, datë 29.3.2006, por edhe më parë ka pasur luhatje lidhur me procedurat e ankimit kundër vendimeve të administratës doganore, e ka dërguar çështjen para Kolegjeve të Bashkuara për unifikimin e praktikës gjyqësore. Kolegjeve u janë shtruar për zgjidhje këto probleme:

1. *Ligji nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” nuk i përfshin në mënyrë të shprehur në fushën e veprimit të tij punonjësit e administratës doganore, në një kohë që të gjitha aktet ligjore e nënligjore që u cituan më lart referojnë në këtë ligj lidhur me procedurat e rekrutimit, kategorizimin e vendeve të punës, si dhe masat disiplinore e procedurat e ankimit kundër tyre. Në këto rrethana a do të konsiderohen punonjësit e administratës doganore si nëpunës të shërbimit civil?*

2. *Referimi në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, lidhur me procedurat e ankimit kundër vendimeve të administratës doganore për largimin nga puna, është bërë me vendime të Këshillit të Ministrave. Nëse punonjësit e administratës doganore do të konsiderohen nëpunës të shërbimit civil, çfarë fuqie do të kishte vendimi i Këshillit të Ministrave nr.172, datë 26.3.2006, i cili parashikon ankimin drejtpërdrejt në gjykatë.*

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vërejnë se, për efekt të unifikimit të praktikës gjyqësore, të njëjtat çështje si më sipër, në thelb, ato i kanë vënë në bisedim duke u dhënë përgjigje ezauruese me vendimin nr.8, datë 12.9.2007 të këtyre Kolegjeve.

Në vendimin unifikues nr.8, datë 12.9.2007, Kolegjet e Bashkuara konkludojnë se “*si statusi i një kategorie të caktuar punonjësish, ashtu dhe juridiksioni i organeve që shqyrtojnë dhe zgjidhin ankimet ndaj vendimeve lidhur me këtë kategori, janë çështje që, nga natyra e tyre, përcaktohen me ligj dhe jo me akte nënligjore*”.

Më tej, në atë vendim unifikues “*Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se ligji nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” nuk shtrihet mbi punonjësit e administratës doganore. Këta të fundit nuk e kanë fituar ndonjëherë këtë status me ligjin e mëparshëm dhe nuk e gëzojnë as me këtë ligj*”.

Në këtë gjykim, për efekt të unifikimit të praktikës gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara vunë në bisedim mënyrën se si do të procedohet me çështjet që janë në shqyrtim.

Në lidhje me punonjësit e sistemit doganor, apo me raste të tjera kur punonjësit nuk janë subjekte të legjislacionit për statusin e nëpunësit civil, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë procedura ankimore ndaj aktit me të cilin është dhënë masa disiplinore, duke iu drejtuar fillimisht juridiksionit administrativ, Komisionit të Shërbimit Civil dhe me pas, ankimi në gjykatë, përbën zbatim të gabuar të ligjit. Duke qenë se procedura e ndjekur ka qenë që në fillim e gabuar, e bën të gjithë procesin të kundërligjshëm.

Në këto raste, juridiksioni për shqyrtimin e ankimit ndaj aktit të dhënies së masës disiplinore është ai gjyqësor dhe jo ai administrativ. Për pasojë, si baza ligjore e përcaktuar, ashtu edhe ndërgjyqësia, që eventualisht mund të krijohet në gjykimin e mosmarrëveshjes me përfshirjen e Komisionit të Shërbimit Civil, konsiderohen të gabuara.

Bazuar në sa arsyetohet më sipër, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se:

Padia në këtë rast është vetë ankimi që paditësi mund t'i ketë drejtuar fillimisht Komisionit të Shërbimit Civil për kundërshtimin e aktit administrativ të dhënies së masës disiplinore, por që gabimisht në vend që t'i jetë drejtuar gjykatës kompetente të rrethit gjyqësor, në fakt i është drejtuar këtij Komisioni. Duke qenë se një ankim i tillë konsiderohet kërkesëpadi, mosmarrëveshja hyn në juridiksionin gjyqësor dhe duhet të shqyrtohet nga gjykata kompetente, sipas rregullave procedurale për gjykimin në shkallë të parë.

Kolegjet e Bashkuara çmojnë se përbën shkelje të ligjit, me pasojë cenueshmërinë e vendimit të gjykatës dhe të vendimit të Komisionit të Shërbimit Civil, ndjekja e rrugës administrative për kundërshtimin e aktit të dhënies së masës disiplinore në atë Komision dhe, më pas, ajo e rrugës gjyqësore.

Padia duhet të ngrihet në gjykatën kompetente të rrethit gjyqësor duke iu referuar dispozitave të Kodit të Punës, Kodit të Procedurës Civile dhe atyre të ligjeve të tjera të posaçme që eventualisht përmbajnë rregulla specifike të lidhura me mosmarrëveshjen që i parashtrohet shqyrtimit gjyqësor.

Ndërsa, nëse janë dhënë, vendimet e Komisionit të Shërbimit Civil dhe të gjykatave me objekt, shkak ligjor e ndërgjyqësi si më sipër, duhet të prishen dhe shfuqizohen respektivisht dhe aktet e gjykimit të çështjes duhet t'i kalojnë për juridiksion e kompetencë gjykatës përkatëse të shkallës së parë, referuar neneve 36, 43/2, 53 e 54 të Kodit të Procedurës Civile. Në rigjykim, gjykata duhet të orientojë palët lidhur me sa është konkluduar dhe mbetet në disponimin e paditësit që të bëjë rregullimet përkatëse lidhur me shkakun dhe objektin e padisë, referuar dispozitës së nenit 185 të Kodit të Procedurës Civile.

Në rrethana të tilla, për efekt të zgjidhjes së çështjes në gjykim, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se gjykata e faktit ka gabuar, kur ka arritur në përfundimin që *“paditësi nuk duhet të ngrinte padi drejtpërdrejt në gjykatën e shkallës së parë, sepse paraprakisht duhet të ezaurojë rrugën administrative të ankimit të aktit administrativ objekt shqyrtimi, duke iu drejtuar Komisionit të Shërbimit Civil”*.

Komisioni i Shërbimit Civil është i ngarkuar me ligj që të zgjidhë ankimet ndaj vendimeve që lidhen vetëm me ata punonjës që gëzojnë statusin e “nëpunësit civil”. Meqenëse paditësi Jorgji Kore nuk e gëzon këtë status, është e bazuar në ligj zgjedhja e tij për ngritjen e padisë drejtpërdrejt në gjykatën e shkallës së parë, me shkak ligjor dhe objekt të mbështetur posaçërisht edhe në dispozitat e Kodit të Punës dhe të Kodit Doganor. Prandaj, çështja objekt gjykimi është në juridiksionin gjyqësor dhe gjykata e faktit duhet të vazhdojë shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të pikës 2 të nenit 141 të Kushtetutës, të shkonjës “a” të nenit 17 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 63 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSËN:

Prishjen e vendimit nr.2340, datë 2.4.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe dërgimin e çështjes në po atë gjykatë për vazhdimin e gjykimit.

Ky vendim për njëhsimin e praktikës gjyqësore, dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. REGJISTRAT E NOTERISË
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PUNËS

KODI I FAMILJES

PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat

Hyri në shtyp më 27.11.2007
Doli nga shtypi më 27.11.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
Tiranë, 2007

Çmimi 20 lekë